

VENDIM
Nr.441, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 561, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT SIPAS GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE
NËNOFICERË, TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Niveli i pagës për gradë, sipas roleve, për punonjësit e Gardës së Republikës”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2009, parashikuar për rritjen e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

NIVELI I PAGËS PËR GRADË SIPAS ROLEVE PËR PUNONJËSIT E GARDËS
SË REPUBLIKËS

Roli i punonjësve sipas gradës		Grada	Paga bazë për gradë
Për punonjësit oficerë	Madhor	Gjeneral garde	107 000
		I lartë	
	I lartë	Kolonel	93 000
		N/kolonel	82 000
		Major	69 000
	I mesëm	Kapiten	58 000
		N/Kapiten	55 000
	I ulët	Toger	52 000
		N/toger	49 000
Për punonjës nënoficerë	Madhor	Kryekapter	41 000
		I lartë	
	I lartë	Kapter	39 000
		Kapter shtabi	38 000
		Kapter mjeshtër	37 000
		I mesëm	
	I mesëm	Kapter i parë	36 500
		Kapter i dytë	36 000
		Kapter i tretë	35 500
	I ulët	Kapter i katërt	34 800
		Rreshter	33 600